



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2020:054238

Datë: 14.03.2023

Numri i dokumentit: 04156558

C.nr.2244/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A. Gj. me adresë në Fushë Kosovë, përfaqësuar nga Av. A. F. me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Telekom i Kosovës Sh.A me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson ligjërishi R. Xh., me objekt kontesti Kompensim për paga jubilarë dhe shujta ditore në punë, jashtë seancës me datë 14.03.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET në tërësi si e themeltë kërkesëpadia e paditësit A. Gj. nga Fushë Kosova dhe DETYROHET e paditura Telekom i Kosovës me seli në Prishtinë për kompensimin e shpërblimit jubilar në emër të pagës jubilarë për periudhën mbi 10 vjeçare përvojë pune, në shumën e përgjithshme prej 3821.48 €, si dhe kompensimin e ushqimit për ditët e prezencës në punë në shumën prej 1656.00 €, me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 19.05.2020 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme prej 794.00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit.

Arsyetim

Paditësi në këtë gjykatë ka parashtruar padi me datë 19.05.2020, nga i autorizuari i tij, si dhe parashtrësën për precizimin e kërkesëpadisë të datës 18.01.2023, me të cilat ka kërkuar që të aprovet kërkesëpadia e paditësit dhe të detyrohet e paditura që paditësit të ia kompensoj në emër të pagës jubilarë për periudhën mbi 10 vjeçare përvojë pune,

shumën prej 3821.48 € , si dhe kompensimin e ushqimit për ditët e prezencës në punë, në shumën prej 1656.00 € , me kamatë ligjore 8% prej ditës së krijimit të obligimit. I autorizuari i paditësit në seancat e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë padisë së parashtruar.

Ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilimin e padisë në shumën prej 104.00 € , për përfaqësim në seancën e mbajtur me datë 21.03.2022 në shumën prej 135.00 € , për përfaqësim në seancën e mbajtur me datë 05.10.2022 në shumën prej 135.00 € , për përfaqësim në seancën e mbajtur me datë 08.12.2022 në shumën prej 135.00 € , për përfaqësim në seancën e mbajtur me datë 18.01.2023 në shumën prej 135.00 € , në emër të pagesës së taksës për ekspertizë financiare në shumën prej 150.00 € , për përfaqësim në seancën e mbajtur me datë 14.03.2023 në shumën prej 135.00 € , në tërësi shumën prej 929.00 € .

I padituri me përgjigje në padi, në seancat e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e paditësit ku kjo padi është e paqartë, e pakuptimtë, konfuze, petitumi është konfuz dhe se nuk mund të kuptohet cili është objekti i kontestit. Më tutje ka theksuar se çështjen e pagave dhe të beneficioneve e ka të rregulluar dhe përcaktuar me Rregulloren për Marrëdhënie të Punës Nr.01-6352/19 të datës 29.11.2019 saktësisht me kreun V të rregullores në fjalë është paraparë se paga, kompensimi i pages, të ardhurat personale dhe të ardhurat e tjera janë të rregulluara me dispozitën e nenit 38 par.9. Poashtu thekson se mos pagesa e një page jubilarë ka ardhur si rezultat se pasi Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve të Telekomit të Kosovës Sh.A ka analizuar raportin intern financiar për vitin 2019 dhe ka gjetur se gjendja financiare e kompanisë ishte përkeqësuar dukshëm në vitin e fundit ku nga 15.600000.00 € humbje sa ishte për vitin 2018 ajo kishte shkuar në ngritje prej 50% 23, 600000.00 € humbje në vitin 2019. Pas shqyrtimit të thënieve të përgjigjes në padi, në seancat e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare, ka theksuar se e kundërshton ekspertizën bazë, plotësimin e saj dhe precizimin e kërkesëpadisë së datës 18.01.2023 sepse nuk ka bazë ligjore andaj i ka propozuar Gjykatës ta refuzoj në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e A. Gj. nga Fushë Kosova të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Av. A. F. nga Prishtina.

Në lidhje me shpenzimet e procedurës ka kërkuar nga gjykata që pala paditëse t'i përfundojë të gjitha shpenzimet e procedurës.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike Gjykata, ka administruar provat si në vijim: Lexohet Vendimi nr.05-1069-2/20 i datës 03.04.2020, lexohet Vërtetimi nr.05-807/2020 I datës 25.02.2020, lexohet Kontrata e Punës nr.01-4145/45/2019 e datës 02.09.2015, lexohet Lista e pagës për paditësin nr.3680 e datës 24.02.2020, lexohet Vendimi i bordit nr.01-1461/20 i datës 15.05.2020, lexohet Raporti i evidencës 27.09.2022, lexohet Marrëveshja kolektive e punës në Telekomin e Kosovës, lexohet ekspertiza e datës 31.03.2022, lexohet plotësim ekspertiza e datës 15.12.2022.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e provave secilës veç e veç dhe të gjithave së bashku, bazuar në nenin 8 të LPK, vendosi që kërkesëpadia e paditësit është e themeltë dhe si e tillë edhe është aprovuar.

Nga provat e administruara gjykata gjeti se paditësi është i punësuar tek i padituri sipas Kontratës së Punës me datë 02.09.2015 ku ka mbi 10 vite përvojë pune i cili ka pasur pagën mujore 625,67 € si dhe kompensimin për shujta ditore për periudhën nga data 01.06.2019 e deri me datën 30.03.2022, në shumën prej 1656.00 € . Paditësi ka parashtruar padi për kompensimin për paga jubilarë përgjatë 10 viteve përvojë pune si dhe për kompensimin e ushqimit për ditët e prezencës në punë, ku i padituri e ka kontestuar në tërësi padinë e paditësit me anë të përgjigjes në padi ku ka kërkuar nga gjykata të refuzohet në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditësit.

Sa i përket shpërblimeve jubilarë, gjykata u bazua në Marrëveshjen Kolektive të Punës në Telekomin e Kosovës e datës 01.06.2019, neni 44.4 I cili thotë së: “Punonjësit në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi I fundit në vlerë:

Për 10 vjet të përvojës në punë, një pagë mujore të tij;

Për 20 vjet të përvojës në punë, dy paga mujore të tij;

Për 30 vjet të përvojës në punë, tri paga mujore të tij;

Pra duke u bazuar në Marrëveshjen Kolektive të Punës në Telekomin e Kosovës e datës 01.06.2019, provat dhe dëshmitë bindëse se paditësi ka mbi 10 vite përvojë pune, doli në përfundim se I takon e drejta e shpërblimit jubilar në vlerë të një page mujore të tij, ku paga mujore e tij është 1087,53 € .Duke u bazuar po në këtë Marrëveshje të nenit 44.3 i cili thotë: “Kompensimi I shpenzimeve të ushqimit për një ditë pune prej 3 € ”.Pra, edhe ky nen tregon në menyrë të qartë se paditësi ka të drejtë në kompensimin e shpenzimeve të ushqimit (shujtave ditore) në vlerë prej 3 € për një ditë pune i cili sipas raportit të evidencës për ditët e punës i nxjerrur nga Departamenti i Burimeve Njerëzore të Telekomit të Kosovës SH.A. i përfshirë prej datës 01.06.2019 kur është nënshkruar Marrëveshja Kolektive e Punës nr.01-3207/19 e Telekomit të Kosovës Sh.a e deri me datën 30.03.2023, paditësi ka 721 ditë pune apo 5768 orë.

Në bazë të Ligjit të Punës të nenit 15 par.2 i cili thotë se “ Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës”. Pra, ky ligj e vërteton faktin se i punësuari duhet të bazohet në Kontratën e Punës të krijuar me punëdhënësin në lidhje me pagën, pagën shtesë dhe kompensimet tjera të parashtruara në Kontratë.

Duke qenë se ka lindur e drejta e paditësit për të kërkuar rrugë gjyqësore në realizimin e së drejtës për kompensimin e pagave jubilarë dhe shujtave ditore ku është legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, ku paditësi ka rolin e kreditorit ndërsa i padituri ka rolin e debitorit. Në kuptim të nenit 245 par.1 të Ligjit nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve i cili përcakton se kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërjegje, në përputhje me përmbajtjen e tij. Rrjedhimisht, duke qenë se e paditura i ka mbetur borxh paditësit tërësisht nga kërkesëpadia e tij, me aplikimin e dispozitës të lartcekur dhe në bazë të gjendjes së

vërtetuar faktike, vendosi ta detyroj të paditurën që paditëses t'i kompensoj shumën si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimin për kamatën gjykata e dha në bazë të nenit 382 par.2 të LMD-së.

Vendimin lidhur me shpenzimet gjykata e mbështeti në dispozitat e neneve 449 dhe 452 të LPK-së ku shpenzimet e procedurës përfshijnë atë për përpilimin e padisë në shumën prej 104.00 €, për përfaqësim në seancën e mbajtur me datë 21.03.2022 në shumën prej 135.00 €, për përfaqësim në seancën e mbajtur me datë 05.10.2022 në shumën prej 135.00 €, për përfaqësim në seancën e mbajtur me datë 08.12.2022 në shumën prej 135.00 €, për përfaqësim në seancën e mbajtur me datë 18.01.2023 në shumën prej 135.00 €, në emër të pagesës së taksës për ekspertizë financiare në shumën prej 150.00 €, gjithsej shuma e përgjithshme prej 794.00 €.

Nga sa u tha më lartë, në përputhje me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Departamenti i përgjithshëm

C.nr.2244/20, me datë 14.03.2023

Gjyqtari

Përparim Zeka

### UDHËZIMI MBI TË DREJTËN E ANKESËS:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të së njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykatë, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palën kundërshtare.